

KOALICIONI PËR KOMRA

DRAFT STATUTI I KOMISIONIT RAJONAL PËR PËRCAKTIMIN E FAKTEVE MBI KRIMET E LUFTËS DHE SHKELJEVE TJERA TË RËNDA TË TË DREJTAVE TË NJERIUT NË HAPËSIRAT E ISH JUGOSLLAVISË

Neni 11.

Obligimi i shteteve për bashkëpunim me Komisionin

1. Të gjitha shtetet kontraktuese janë të detyruara të bashkëpunojnë me Komisionin, dhe ti mundësojnë kryerjen e detyrave në formë efikase në përputhje me Statutin.
2. Organet kompetente të pushtetit në shtetin kontraktues, në kërkesë të Komisionit, me kohë do të sigurojnë qasje në të dhëna, duke përfshirë edhe marrjen e deklaratave nga përfaqësuesit e institucioneve shtetërore dhe zbatimin e hulumtimeve në teren, përveç nëse me këtë do të shkeleshin dispozitat e shtetit kontraktues mbi konfidencialitetin e të dhënave.
3. Të dhënat, ose dokumentet, që kanë për qëllim fshehjen e veprës së kryer penale, ose që janë të drejtuara në shkelje të rënda të të drejtave themelore të njeriut, nuk konsiderohen si sekret.
4. Në rastin kur shteti konsideron që zbulimi i të dhënave të caktuara ose dokumenteve të cilat i ka kërkuar Komisioni do të jenë në kundërshtim me dispozitat mbi konfidencialitetin e të dhënave, do të ndërmer të gjitha masat e arsyeshme me qëllim të tejkalimit të situatës kontestuese, me angazhim të përbashkët të Komisionit dhe Shtetit. Këto masa nënkuptojnë:
 - (a) Sqarimin e Komisionit lidhur me relevancën e të dhënave apo dokumenteve të cilat i kërkon; dhe/apo
 - (b) Marrëveshjen mbi kushtet e zbulimit të të dhënave, duke përfshirë, ndër të tjera, zbulimin e pjesëshëm të përmbajtjes së dokumenteve, kufizimin në publikimin e të dhënave si dhe zbatimin e masave tjera mbrojtëse mbi konfidencialitetin e të dhënave.

Nëse duam ti vërtetojmë faktet të cilat nënkuptojnë të vërtetën e qind për qind të atëherë nuk guxon të ketë dokumente sekrete, të fshehta. (Jovana Ramović, Fakulteti Juridik në Universitetin e Podgoricës, Podgoricë, Mali i Zi, Konsultime rajonale me studentët dhe shkencëtarët e rinj mbi hartimin e Statutit të KOMRA-së, Zagreb, Kroaci, 17 dhjetor 2010)

PJESA IV – QËLLIMET DHE DETYRAT E KOMISIONIT

Neni 12.

Qëllimet e Komisionit

Komisioni ka këto qëllime:

- (a) të vërtetojë faktet për krimet e luftës dhe shkeljet e rënda të të drejtave të njeriut, të kryera në hapësirat e RSFJ-së së dikurshme, në periudhën nga 1 Janari i vitit 1991 deri më 31 Dhjetor të viti 2001, rrethanat shoqërore dhe politike të cilat

kanë ndikuar në kryerjen e këtyre veprave dhe pasojat të cilat janë rrjedhojë e këtyre krimeve dhe shkeljeve të të drejtave;

- (b) të kontribuojë që elitat politike dhe shoqëritë në shtetet kontraktuese të pranojnë faktet mbi krimet e luftës dhe shkeljet e rënda të të drejtave të njeriut.

*(...) në nenin 12., paragrafi b), thotë se do të ndihmojnë të pranohen faktet, pranimi është element subjektiv dhe mendoj se **komisioni nuk do të mund të kontribuojë që dikush të pranojë diçka, por duhet të thuhet – “të jenë të njohur”**. (Jovana Ramović, Fakulteti Juridik në Podgoricë, Podgoricë, Mali i Zi, Konsultime rajonale me studentët dhe shkencëtarët e rinj mbi hartimin e Statutit të KOMRA-së, Zagreb, Kroaci, 17 dhjetor 2010)*

- (c) të kontribuojë në ndriçimin e fatit të humburve – pagjeturve;

- (d) të pranojë padrejtësitë e shkaktuara ndaj viktimave, me qëllim të ndërtimit të kulturës së solidaritetit dhe bashkëndjenjës për viktimat;

*‘të pranojë padrejtësitë e shkaktuara viktimave’, mendoj se këtu gjërat janë parashtruar në mënyrë të gabuar, sepse kush do të pranojë? Ne apo ata njerëz të cilët do të jenë në Komision? Ata të cilët e mbështesin komisionin, ata veçse e pranojnë. Mendoj se është e rëndësishme të shtohet **që shtetet themeluese ta pranojnë atë padrejtësi**. (Edin Smailović, Fakulteti Filozofik në Universitetin e Lubjanës, Bijelo Polje, Mali i Zi, Konsultime rajonale me studentët dhe shkencëtarët e rinj mbi hartimin e Statutit të KOMRA-së, Zagreb, Kroaci, 17 dhjetor 2010)*

- (e) të kontribuojë në realizimin e të drejtës së viktimave; dhe

- (f) të kontribuojë në pengimin e përsëritjes së krimeve të luftës dhe të shkeljeve të rënda të të drejtave të njeriut.

Neni 13.

Detyrat e Komisionit

Komisioni ka këto detyra:

- (a) të grumbulloj të dhëna për rastet e shkeljeve të rënda të të drejtave të njeriut dhe krimeve të luftës, të ofrojë përshkrim të detajuar për to, dhe të pasqyrojë përmes formularëve shkeljet e të drejtave dhe pasojat e tyre;
- (b) të grumbullojë të dhëna për fatin e të humburve dhe të bashkëpunojë me trupat kompetente të cilat, në shtetet kontraktuese, merren me hulumtimin për të zhdukurit;
- (c) të bëjë inventarizimin e humbjeve njerëzore për:
 - i. civilët të cilët kanë humbur jetën ose kanë humbur në ndërlidhje me luftën ose me forma tjera të konfliktit të armatosur; dhe

- ii. luftëtarët të cilët kanë humbur jetën, ose kanë humbur në ndërlidhje me luftën ose me forma tjera të konfliktit të armatosur;

(...) këtu thuhet “civilët të cilët janë vrarë apo janë zhdukur në lidhje me luftën apo format tjera të konflikteve të armatosura”, do të mund të shkruhet presje (,) me theks të veçantë në listën e viktimave fëmijë. (Almin Škrijelj, Fakulteti Filozofik në Universitetin e Sarajevës, Departamenti për gjuhë dhe letërsi franceze, Shoqata e juristëve dhe Shoqata e familjarëve të luftëtarëve të vrarë, Sarajevë, BeH, Konsultime rajonale me studentët dhe shkencëtarët e rinj mbi hartimin e Statutit të KOMRA-së, Zagreb, Kroaci, 17 dhjetor 2010)

- (d) të mbledhë të dhëna për vendet e mbylljeve në lidhje me luftën apo në forma tjera të konflikteve të armatosura, të personave të cilët janë arrestuar në mënyrë të paligjshme, u janë nënshtruar torturës dhe trajtimit jo njerëzorë, dhe të hartojë listën gjithëpërfshirëse të tyre duke mbrojt identitetin e tyre aty ku është e nevojshme;

- (e) [ALT. A: të hulumtojë rrethanat politike dhe shoqërore të cilat bindshëm kanë kontribuar në shpërthimin e luftës apo formave tjera të konflikteve të armatosura, si dhe faktin e krimeve të luftës dhe shkeljeve të rënda të të drejtave të njeriut]

[ALT. B: të hulumtojë rrethanat politike dhe shoqërore të cilat, duke filluar nga viti 1980, bindshëm kanë kontribuar në shpërthimin e luftës dhe të konflikteve tjera të armatosura, si dhe faktin e krimeve të luftës dhe të shkeljeve të rënda të të drejtave të njeriut];

- (f) të mbajë dëgjime publike të viktimave dhe personave tjerë për krimet e luftës dhe shkeljeve të të drejtave të njeriut;

- (g) të rekomandojë marrjen e masave të cilat kanë të bëjnë me parandalimin e përsëritjes së shkeljeve të rënda të të drejtave të njeriut dhe dëmshpërblimin për viktimat; dhe

(...) te detyrat, nën g), “të propozojë masat të cilat kanë të bëjnë me parandalimin e përsëritjes së shkeljeve të të drejtave të njeriut”, mendoj se këtu komisioni do të duhej të hartojë një varg të tërë të rekomandimeve të cilat do të kenë të bëjnë kryesisht me ndryshimet në edukim. Konkretisht mendoj në lëndën e historisë, ku do të ishte shumë me rëndësi të bëhen ndryshimet. (Edin Smailović, Fakulteti Filozofik në Universitetin e Lubjanës, studimet post-diplomike, Bijelo Polje, Mali i Zi, Konsultime rajonale me studentët dhe shkencëtarët e rinj mbi hartimin e Statutit të KOMRA-së, Zagreb, Kroaci, 17 dhjetor 2010)

- (h) Të hartojë, publikojë dhe ta paraqesë raportin përfundimtar në atë mënyrë që të mundësojë që raporti të arrijë deri te një rreth i gjerë i njerëzve në shtetet e ish territorit të Jugosllavisë.

Neni 14

Periudha dhe territori i hulumtimimit

Komisioni vërteton faktet për krimet e luftës dhe shkeljeve të rënda të të drejtave të njeriut të kryera në periudhën prej 1. janar 1991 deri 31. dhjetor 2001, në territorin e shteteve të ish RSFJ-së, dhe hulumton

[ALT. A: hulumton rrethanat politike dhe shoqërore të cilat bindshëm kanë ndikuar në shpërthimin e luftës dhe të formave tjera të konflikteve të armatosura, si dhe faktin e krimeve të luftës dhe të shkeljeve të rënda të të drejtave të njeriut].

[ALT. B: rrethanat politike dhe shoqërore të cilat, duke filluar nga viti 1980, bindshëm kanë ndikuar në shpërthimin e luftës dhe formave tjera të konflikteve të armatosura, si dhe faktin e krimeve të luftës dhe shkeljeve të rënda të të drejtave të njeriut].

(...) duhet të merret periudha prej vitit 1918. Pse mendoj kështu? Sepse atëherë është formuar një shtet prej të cilit rrjedhim të gjithë, ai është shteti i Serbëve, Kroatëve dhe Sllovenëve i cili më vonë, në vitin '29 është emërtuar Jugosllavi. (Damir Nikočević, Fakulteti i shkencave politike, Herceg Novi, Mali i Zi, Konsultime rajonale me studentët dhe shkencëtarët e rinj mbi hartimin e Statutit të KOMRA-së, Zagreb, Kroaci, 17 dhjetor 2010)

Tani duke biseduar me kolegun afër meje, u propozojmë alternativën e tretë – fshijini ato dy alternativat e para. Komisioni nuk duhet ta ketë mandatin (kompetencën) për të hulumtuar rrethanat politike dhe shoqërore. (Timčo Mucunski, Fakulteti Juridik Justiniani i Parë, Shkup, Maqedoni, Konsultime rajonale me studentët dhe shkencëtarët e rinj mbi hartimin e Statutit të KOMRA-së, Zagreb, Kroaci, 17 dhjetor 2010)

(...) periudha kohore prej vitit 1980. [është] e qëlluar. Dhe (...) vetëm [ai] vit është i duhuri për tu hulumtuar si periudhë kohore. Pse? Sepse individët e krijojnë të keqen, e jo rrethanat historike. (Edin Smailović, Fakulteti Filozofik, Universiteti i Lubjanës, studimet post diplomike, Bijelo Polje, Mali i Zi, Konsultime rajonale me studentët dhe shkencëtarët e rinj mbi hartimin e Statutit të KOMRA-së, Zagreb, Kroaci, 17 dhjetor 2010)

(...) kam një propozim i cili ndoshta në kuadër të statutit të komisionit do të mund të bëhet nen, me të cilin komisioni për një kohë të caktuar do të jetë i obliguar të formojë një organ i cili do të merrej pikërisht me këto çështje [hulumtimin e rrethanave politike dhe shoqërore]. (Aleksandra Đorđević, Fakulteti Juridik, Universiteti në Nish, Iniciativa e të rinjve për të drejtat e njeriut, Beograd, Serbi, Konsultime rajonale me studentët dhe shkencëtarët e rinj mbi hartimin e Statutit të KOMRA-së, Zagreb, Kroaci, 17 dhjetor 2010)

viti 1980, me të vërtetë nuk është viti prej të cilit duhet filluar, por duhet të shkojmë më larg ndoshta deri te viti '41, edhe pse kjo do të jetë punë shtesë për komisionin. (Seid Burić, Fakulteti Juridik në Universitetin e Sarajevës, Sarajevë, BeH, Konsultime rajonale me studentët dhe shkencëtarët e rinj mbi hartimin e Statutit të KOMRA-së, Zagreb, Kroaci, 17 dhjetor 2010)

Neni 15

Shkeljet e të drejtave në kompetencën e Komisionit

Komisioni vërteton faktet lidhur me krimet kundër njerëzimit dhe kundër të drejtave humanitare ndërkombëtare, si dhe faktet lidhur me shkeljet tjera të rënda të të drejtave të njeriut.

(...) mendoj se nuk duhet të hiqet momenti ku thotë “ nuk kufizohet në”; pikërisht për shkak të rastit të “të fshirëve” në Slloveni, sepse rasti i tyre nuk është as fizik e as psikofizik, trajtim johuman ndaj tyre, por ata thjesht kanë qenë të fshirë në mënyrë apo gabim administrativ.

(Nataša Stamenković, Fakulteti Juridik *Justiniani i Parë*, Shkup, Maqedoni, Konsultime rajonale me studentët dhe shkencëtarët e rinj mbi hartimin e Statutit të KOMRA-së, Zagreb, Kroaci, 17 dhjetor 2010)

(...) krimet e luftës që kanë qenë të larguar, sipas meje nuk është dashur (të largohen), siç është paraqitur në shumë paragrafë dhe se ka shumë krime të luftës të cilët nuk i takojnë krimeve tjera të radhitura në alternativën A, ndoshta nuk duhet të radhiten gjithë ato veprime, pos sipas mendimit tim ashtu si ka qenë më parë, ajo ka qenë zgjedhje shumë më e mirë.

(Ana Oštir, Fakulteti Juridik, Universiteti në Lubjanë, Lubjanë, Slloveni, Konsultime rajonale me studentët dhe shkencëtarët e rinj mbi hartimin e Statutit të KOMRA-së, Zagreb, Kroaci, 17 dhjetor 2010)

PJESA VI. – AUTORIZIMET E KOMISIONIT

Neni 16

Marrja e deklaratave

1. Komisioni merr deklaratat për krimet e luftës dhe shkeljet e rënda të të drejtave të njeriut bazuar në kompetencën e saj nga shtetet, dëshmitarët, përfaqësuesit e institucioneve dhe kryesit e veprave.
2. Secili person të cilit Komisioni i dërgon thirrjen është i/e obliguar të japë deklaratë. Përveç, viktimat japin deklaratë në bazë vullnetare.

(...) komisioni do të humbë një pjesë të madhe të vlerës së saj, nëse nuk arrin ti bindë dëshmitarët që të dëshmojnë, përpos viktimave natyrisht.

(Ivan Đurić, Akademia për diplomaci dhe siguri, Beograd, Serbi, Konsultime rajonale me studentët dhe shkencëtarët e rinj mbi hartimin e Statutit të KOMRA-së, Zagreb, Kroaci, 17 dhjetor 2010)

3. Në rastin kur personi refuzon të japë deklaratë Komisionit, duke u thirrë në të drejtën e detyrimit ligjorë për ruajtjen e fshehtësisë së të dhënave, atëherë aplikohet dispozita e nenit 11, paragrafët 3 dhe 4, të këtij Statuti.
4. Dispozitat e ligjit të procedurës penale të ligjit të shtetit nënshkruar aplikohen në bazë të të drejtës të refuzojë të japë përgjigje në pyetjet e caktuara si dhe lirim nga obligimi për

dëshmi dhe pyetje tjera në lidhje me hetimin e personave të cilët nuk janë të rregulluara me Statutin e Komisionit.

5. Me kërkesë të dhënësit të deklaratës, Komisioni mund të ofrojë mundësinë e dhënies së deklaratës me mbrojtje të identitetit.
6. Komisioni mund të lidhë marrëveshje të veçanta me shtetet nënshkruese për mënyrën e thirrjes së personave nga paragrafi 1. Nëse këtë e konsideron të përshtatshme [HRV.: leverdishme], Komisioni mund ti propozojë gjykatës kompetente që me procedurë urgjente të vendosë për zbatimin e masave për sigurimin e pranisë së personit, në pajtim me ligjin për procedurë penale të shtetit në të cilin personi është i regjistruar, gjegjësisht është me banim aty.
7. Gjatë dhe pas dhënies së deklaratës para Komisionit, sipas nevojës, të sigurojë mbështetje psikosociale për viktimën.
8. Komisioni i merr deklaratat:
 - a. në vendin e banimit të përhershëm apo të përkohshëm të dhënësit të deklaratës;
 - b. në zyrat e Komisionit;
 - c. në përfaqësitë diplomatike–konsullata të shteteve nënshkruese, nëse deklarata merret në shtetet e treta; dhe
 - d. Në territorin e shteteve të treta, nëse kjo nuk është në kundërshtim me dispozitat ligjore të atyre shteteve, në rastet kur viktimat, dëshmitarët dhe personat tjerë nuk mund t'i japin deklaratat në konsullatat apo ambasadat e shteteve nënshkruese.

Neni 19

Dëgjimet publike të viktimave dhe personave tjerë

1. Komisioni organizon dëgjimet publike në të cilat viktimat flasin për vuajtjet e tyre dhe vuajtjet e të afërmeve të tyre.
2. Dëgjimet publike përfshijnë edhe kryesit e veprave të cilat kanë karakter të krimit të luftës apo shkeljeve të rënda të të drejtave të njeriut, dëshmitarët, si dhe personat të cilët u kanë ndihmuar viktimave.
3. Dhënia e deklaratave në dëgjimet publike është në bazë vullnetare.
4. Gjatë dëgjimeve publike, Komisioni mund të sigurojë masat e mbrojtjes së identitetit, si dhe masat e veçanta për mbrojtjen psikike dhe fizike të integritetit.

5. Mediat elektronike në pronësi shtetërore, apo publike, në territorin e ish RSFJ-së, transmetojnë dëgjimet publike në formë integrale apo të shkurtuar. Mënyra e transmetimit të dëgjimeve publike rregullohet në bazë të marrëveshjes mes Komisionit dhe shërbimeve publike. Transmetuesit privatë kanë të drejtë të transmetojnë dëgjimet publike, me të njëjtat rregulla të cilat vlejnë edhe për mediat në pronësi shtetërore, gjegjësisht të shërbimeve publike.

Shërbimet publike, gjegjësisht dikur mediet shtetërore kanë pasur rol të rëndësishëm gjatë kohës së ngjarjeve të luftës, si në vendin tim ashtu edhe në vendet tjera, shpesh herë negative, rrallë herë pozitive dhe prandaj do të ishte më mirë poqese shërbimet publike do ta kenë obligim të bëjnë transmetimin e dëgjimeve publike. (Danilo Ajković, Fakulteti Juridik, Podgoricë, Mali i Zi, Konsultime rajonale me studentët dhe shkencëtarët e rinj mbi hartimin e Statutit të KOMRA-së, Zagreb, Kroaci, 17 dhjetor 2010)

6. Dëgjimet publike mund të organizohen në vende (lokalitete) të ndryshme.

Neni 20

Mbajtja e seancave tematike

1. Komisioni mund të mbajë seanca për aktivitete e institucioneve shtetërore, organizatave politike, institucioneve kulturore dhe shkencore, komuniteteve fetare dhe kishave, dhe të mediave në prag të luftës dhe gjatë saj, gjegjësisht të formës tjetër të konfliktit të armatosur, e që kanë të bëjnë me krimet e luftës dhe shkeljet e rënda të të drejtave të njeriut.

(...) “kishat dhe bashkësitë fetare” duhet të shëndrrohen vetëm në “bashkësi fetare”, sepse në të gjitha shtetet e rajonit miratohen ligjet për bashkësitë fetare, e jo për kisha dhe bashkësi fetare (...) sipas mendimit tuaj a është e argumentuar sipas aspektit politik, që të shkohet me gjykimin e kishave apo bashkësive fetare? Sipas meje, ky është një proces i rrezikshëm dhe mund të shëndrrohet në kutinë e Pandorës.. (Timčo Mucunski, Fakulteti Juridik Justiniani i Parë, Shkup, Maqedoni, Konsultimet rajonale me studentët dhe shkencëtarët e rinj mbi hartimin e Statutit të KOMRA-së, Zagreb, Kroaci, 17. dhjetor 2010.)

2. Mediat elektronike në pronësi shtetërore, apo publike, në territorin e ish RSFJ-së transmetojnë, në formë integrale apo të shkurtuar, seancat tematike të Komisionit. Mënyra e transmetimit rregullohet në bazë të marrëveshjes mes Komisionit dhe shërbimeve publike. Transmetuesit privatë kanë të drejtë të transmetojnë dëgjimet publike, me të njëjtat rregulla të cilat vlejnë edhe për mediat në pronësi shtetërore, gjegjësisht të shërbimeve publike.
3. Dëgjimet publike mund të organizohen në vende (lokalitete) të ndryshme.

Neni 23

Kriteret për zgjedhjen e anëtarëve dhe anëtareve

1. Anëtari/anëtarja e Komisionit është:

- (a) shtetas/shtetase i/e shtetit nënshkrues/e;
- (b) person me vlera të larta të karakterit dhe moralit, me integritet dhe autoritet, i/e përkushtuar dialogut tolerant dhe zgjedhjes konstruktive të konflikteve, i/e cili/a mund ta gëzojë besimin në të gjitha shtetet nënshkruese; dhe

*(...) neni 23., thotë – “i cili mund ta gëzojë besimin në të gjitha shtetet nënshkruese, ndërsa në nenin e rishkruar thotë vetëm “i cili gëzon besimin”. Mendoj se është shumë e vështirë të gjendet personi sipas këtyre kriterëve, prandaj ndoshta është më mirë të lihet **“mund të gëzojë”** sepse supozohet se personi i cili ka kualitete të larta morali, personi me integritet të lartë e kështu me radhë, potencialisht mund ta ketë besimin, ndërsa është vështirë të gjendet personi i cili do ta ketë apo gëzojë besimin në të gjashtë shtetet.* (Jovana Ramović, Fakulteti Juridik i Univerzitetit të Podgoricës, Podgoricë, Mali i Zi, Konsultime rajonale me studentët dhe shkencëtarët e rinj mbi hartimin e Statutit të KOMRA-së, Zagreb, Kroaci, 17 dhjetor 2010)

*(...) këtu flitet për personin i cili ka dhe gëzon besimin, ajo që dua të them sipas përvojës malaziase, mendoj se do të ishte më mirë të **shtohet**, personi i cili **gëzon “besimin e pandarë”**.* (Edin Smailović, Fakulteti Filozofik, Universiteti në Lubjanë, studimet post diplomike, Bijelo Polje, Mali i Zi, Konsultime rajonale me studentët dhe shkencëtarët e rinj mbi hartimin e Statutit të KOMRA-së, Zagreb, Kroaci, 17 dhjetor 2010)

- (c) Person me aftësi psikiko-fizike për të kryes me efikasitet dhe në kontinuitet detyrën e anëtarit/anëtares së Komisionit.
2. Në shtetin nënshkrues zgjidhet së paku një femër, gjegjësisht së paku një mashkull, për anëtarë/anëtare të Komisionit.
3. Në shtetin nënshkrues, gjatë zgjedhjes së anëtarit dhe anëtares së Komisionit, tentohet të sigurohet përbërje etnike e përfaqësuesve të Komisionit, ashtu që përpos pjesëtarëve/pjesëtareve të komunitetit më të madhe etnik të zgjidhet edhe një apo më shumë pjesëtarë/pjesëtare të komunitetit tjetër etnik, gjegjësisht të komuniteteve tjera etnike në atë shtet.

*Bëhet fjalë për përmbajtjen të përfaqësimit etnik të komisionit. E marr si shembull Maqedoninë ku është paraparë që të ketë dy përfaqësues nga dy komunitete etnike. Në Maqedoni jetojnë më shumë se dy komunitete etnike, prandaj propozoj të **shtohet pjesa ku do të thuhet se përfaqësuesit nga një shtet duhet t'i kenë parasysh viktimat nga të gjitha komunitetet etnike të cilat jetojnë në atë shtet.*** (Miroslava Simonovska, Shkolla e lartë e gazetarisë dhe marrëdhënieve me publik, Shkup, Maqedoni, Konsultime rajonale me studentët dhe shkencëtarët e rinj mbi hartimin e Statutit të KOMRA-së, Zagreb, Kroaci, 17 dhjetor 2010)

(...) bëhet fjalë për nenin 23., paragrafi 3., - “**do të tentojë**” kjo fjalë (...) nuk duhet të qëndrojë, sepse të tentojë është fjalë e dykuptimë, të jetë apo mos të jetë (...) Kështu që kjo fjalë duhet të **fshihet**. (Almin Škrijelj, Fakulteti Filozofik, Universiteti në Sarajevë, Departamenti për gjuhë dhe letërsi franceze, Shoqata e Juristëve dhe Shoqata e familjeve të luftëtarëve të vrarë, Sarajevë, BeH, Konsultime rajonale me studentët dhe shkencëtarët e rinj mbi hartimin e Statutit të KOMRA-së, Zagreb, Kroaci, 17 dhjetor 2010)

4. Anëtari/anëtarja e Komisionit nuk mund të jetë personi:

- (a) i/e cili/a ka kryer funksion të shquar politik në dy vitet e fundit para shpalljes së konkursit për zgjedhjen e anëtarit/anëtares për Komision, apo në periudhën kohore e cila përfshinë kompetencën e Komisionit;

(...) **dikush që mund të japë dorëheqje sot, pas dy vitesh mund të inkuadrohet në KOMRA-në, për shembull, politikani i cili ka qenë aktiv atëherë dhe është edhe sot, mund të kyçet në KOMRA, ndërsa ka bërë krime të mëdha gjatë luftës nacionale.** (Damir Nikočević, Fakulteti i shkencave politike, Herceg Novi, Mali i Zi, Konsultime rajonale me studentët dhe shkencëtarët e rinj mbi hartimin e Statutit të KOMRA-së, Zagreb, Kroaci, 17 dhjetor 2010)

(...) e keni shkruar “**funksion i shquar politik**” (...) mendoj se **duhet të shkruhet një term shumë më i saktë**, dallimi mes funksionit politik dhe funksionit të shquar politik është shumë i madh, duhet të jetë shumë më precize edhe pse thoni se nuk do të tentoni ti theksoni të gjitha termet politike, në këto do të mund të thirren shtetet kur do të pranohet iniciativa, prandaj duhet **paraprakisht të krijojmë mbrojtjen nga kjo.** (Jovana Ramović, Fakulteti Juridik, Universiteti në Podgoricë, Podgoricë, Mali i Zi, Konsultime rajonale me studentët dhe shkencëtarët e rinj mbi hartimin e Statutit të KOMRA-së, Zagreb, Kroaci, 17 dhjetor 2010)

- (b) Për të cilin ekziston dyshim serioz se është përgjegjës për shkeljen e të drejtave të njeriut dhe të drejtave humanitare ndërkombëtare, apo e ka përkrahë, ndihmuar apo ka nxitë kryerjen e këtyre veprave, apo ka kontribuar në mosndëshkimin për këto vepra, apo ka qenë i lidhur ngushtë me personin e dënuar, akuzuar apo që është nën hetime për vepra të tilla.

sipas mendimit tim ajo që është paraqitë këtu është paksa e tepërt, si “**anëtarë i komisionit nuk mund të jetë personi i cili është ngushtë i lidhur me personin e gjykuar, akuzuar apo i cili është nën hetime për atë lloj vepre**” Mendoj se **kjo është mënyrë mesjetare e kufizimit të asaj se kush do të jetë anëtarë, sepse dikush mund të jetë për shkaqe objektive ngushtë i lidhur me atë person, por ti ketë qëndrimet dhe veprimet diametralisht të kundërta nga ai person. (...) që të mbrohemi nga konflikti i interesave mund të propozojmë që ai person të tërhiqet nga votimi apo çfarëdo veprimi tjetër.** (Pjesëmarrës i paidentifikuar, Konsultime rajonale me studentët dhe shkencëtarët e rinj mbi hartimin e Statutit të KOMRA-së, Zagreb, Kroaci, 17 dhjetor 2010)

(...) zgjidhje mjaft e dobët për shkak se pastaj secili do të mund të thirret në atë se është larguar për shkak të posedimeve të tjetrit. (Danilo Ajković, Fakulteti Juridik, Podgoricë, Mali i Zi, Konsultime rajonale me studentët dhe shkencëtarët e rinj mbi hartimin e Statutit të KOMRA-së, Zagreb, Kroaci, 17 dhjetor 2010)

(...) paksa më frikëson momenti a do të pranonin viktimat me të vërtetë të dëshmojnë nëse i shohin pjesëtarët ushtarak apo të strukturave paramilitare [si anëtarë të KOMRA-së], a do ta kenë akoma qëndrimin për KOMRA-në si e pavarur, e pa politizuar [organ]. (Nataša Stamenković, Fakulteti Juridik *Justiniani i Parë*, Shkup, Maqedoni, Konsultime rajonale me studentët dhe shkencëtarët e rinj mbi hartimin e Statutit të KOMRA-së, Zagreb, Kroaci, 17 dhjetor 2010)

Neni 26.

Përbërja dhe zgjedhja e Këshilleve seleksionuese

1. Këshilli seleksionues në secilin shtet e përbëjnë 9 anëtarë/anëtare, të cilët duhet ti plotësojnë kriteret të cilat vlejné për përzgjedhjen e anëtarëve/anëtareve të Komisionit, përveç ndalesës për kryerjen e funksioneve politike në periudhën në dy vitet e fundit para shpalljes së konkursit për zgjedhjen e anëtarëve dhe anëtareve të Komisionit, dhe në periudhën e cila përfshihet në kompetencën e Komisionit.
2. Anëtarët/anëtares e Këshillit seleksionues nuk mund të kandidohen për anëtarësim në Komision.
3. Tre anëtarët/anëtares e Këshillit seleksionues i emëron ministri kompetent për të drejtat e njeriut, në pëlqim të Komisionit parlamentar ose të Komisionit kompetent për të drejtat e njeriut ose marrëdhënie ndërnacionale.
4. Tre anëtarë/anëtare të Këshillit seleksionues përzgjidhen nga anëtarët e Koalicionit për KOMRA në shtetin kontraktues.
5. Gjashtë anëtarët/anëtares e para të Këshillit seleksionues emërohen, gjegjësisht zgjedhën në bazë të paragrafit 3 dhe 4 të këtij neni në afat prej 45 ditësh, nga dita e ratifikimit të fundit të Kontratës ndërkombëtare për themelimin e Komisionit.
6. Ministri kompetent shpallë zgjedhjen e katër anëtarëve dhe anëtareve të Komisionit seleksionues, dhe në afat prej 8 ditësh shpall konkursin për zgjedhjen edhe të 3 anëtarëve/anëtareve të komisionit.
7. Gjashtë anëtarët/anëtares e emëruar ose të përzgjedhur paraprakisht do të vazhdojnë me përzgjedhjen e tre anëtarëve/anëtareve të mbetur të Këshillit me konsensus dhe nëse një gjë e tillë nuk do të jetë e mundur, atëherë zgjedhja bëhet me shumicë të votave.
8. Ministri kompetent, Koalicioni për KOMRA dhe anëtarët/anëtares e Këshillit seleksionues të emëruar dhe përzgjedhur në bazë të paragrafëve 3 dhe 4 të këtij neni, do të sigurojnë që së paku 1/3 të anëtarësisë ta përbëjnë femrat, gjegjësisht meshkujt, dhe do të përkushtohen që të sigurojnë që 1/3 të anëtarësisë ta përbëjnë përfaqësuesit/përfaqësueset e shoqatës së viktimave, duke përfshirë edhe shoqatat e viktimave të cilat nuk janë anëtare të Koalicionit për KOMRA, me kusht që të jenë të regjistruara së paku tri vjet para nënshkrimit të kontratës për themelimin e Komisionit.

Për çfarë arsye është e obligueshme barazia gjinore dhe pse po i jepet përparësi në krahasim me gjërat tjera të cilat mua po më duken më të rëndësishme, gjegjësisht që aty të jenë përfaqësuesit e shoqatave apo të popujve pakicë? (Ivan Đurić, Akademia për diplomaci dhe siguri, Beograd, Serbi, Konsultime rajonale me studentët dhe shkencëtarët e rinj mbi hartimin e Statutit të KOMRA-së, Zagreb, Kroaci, 17 dhjetor 2010)

9. Ministri kompetent shpallë zgjedhjen e Këshillit seleksionues dhe i siguron kushtet për punën e tij.
10. Me Këshillin seleksionues kryeson anëtari/anëtarja më i/e moshuar, i/e cili/a cakton mbajtjen e seancën konstitutive në afat prej 45 ditësh nga dita e shpalljes së konkursit nga paragrafi 6 i këtij neni.

Neni 27.

Zgjedhja e kandidatëve/kandidateve për anëtarësim në Komision nga ana e këshillit përzgjedhës

1. Këshilli seleksionues, në secilin shtet në afat prej 8 ditësh nga dita e mbajtjes së mbledhjes konstitutive, shpallë konkurs për zgjedhjen e anëtarëve dhe anëtareve të Komisionit, në afat prej 30 ditësh.
2. Në afat prej 8 ditësh, nga dita e mbylljes së konkursit, Këshilli seleksionues shpallë në internet faqen e Ministrisë kompetente sipas neni t 26, paragrafi 3, si vijon:
 - (a) Numrin e përgjithshëm të kandidaturave të arritura;
 - (b) Listën e emrave të kandidatëve/kandidateve, kandidaturat e të cilëve janë refuzuar ose nuk kanë përmbajtur informacionet e kërkuara me konkurs, në lidhje me përmbushjen e kriterit të paraparë me nenin 23 të Statutit; dhe
 - (c) Listën e emrave të kandidatëve/kandidateve, kandidaturat e të cilëve do të shqyrtohen.
3. Këshilli seleksionues mund të vendosë që ti intervistojë të gjithë ose disa prej kandidatëve/kandidateve. Intervista është e hapur për publik.

(...) mendoj se paneli zgjedhor duhet ti intervistojë të gjithë (...) [kandidatët], pikërisht për shkak të përzierjes së shteteve në përzgjedhje. (Jovana Ramović, Fakulteti Juridik, Universiteti në Podgoricë, Podgoricë, Mali i Zi, Konsultime rajonale me studentët dhe shkencëtarët e rinj mbi hartimin e Statutit të KOMRA-së, Zagreb, Kroaci, 17 dhjetor 2010)

4. Këshilli seleksionues mund të kërkojë informata për kandidatin/kandidaten nga organet shtetërore dhe institucionet publike, ndërsa ato janë të obliguara që në atë kërkesë të përgjigjen me urgjentisht.
5. Këshilli seleksionues vlerëson plotësimin e kushteve të kandidatëve/kandidateve, kandidaturat e të cilëve i ka marrë në shqyrtim dhe e ngushton përzgjedhjen në listën e cila

përmban numrin për dy deri në tre herë më të madh të kandidatëve dhe kandidateve nga nuri i anëtarëve dhe anëtareve të Komisionit, të cilit zgjedhën në shtetin kontraktues.

6. Në afat prej 40 ditësh, nga dita e mbylljes së konkursit Këshilli seleksionues shpallë listën e kandidatëve/kandidateve, dhe të njëjtën ia dërgon, po të njëjtën ditë, kryetarit/kryesisë së shtetit kontraktues.
7. Në afat prej 40 ditësh, nga dita e mbylljes së konkursit Këshilli seleksionues shpallë listën e kandidatëve/kandidateve, dhe të njëjtën ia dërgon, po të njëjtën ditë, kryetarit/kryesisë së shtetit kontraktues.

(...) çdo Asamble apo organ legjislativ i shteteve të cilat do të jenë shtete nënshkruese, në perspektivë kanë **komitetet e përhershme të të drejtave të njeriut**. Propozoj që nga ato komitete të përhershme të rrjedhin propozimet për anëtarët, e pastaj në kuvende të zgjidhen ata anëtarë, me faktin se ne në Republikën e Maqedonisë e shfrytëzojmë (...) **Sistemin e Badenterit** apo metodën e cila është e njohur sipas gjykatësit francez Robert Badenter, i cili është dy të tretat e shumicës. **Dy të tretat e shumicës për tërë organin legjislativ [komitetin] dhe dy të tretat shtesë të shumicës nga vetë organi legjislativ**. Propozimi im rrjedh nga agjencionet legjislative, të cilat në shumicën e rasteve përzgjidhen me dy të tretat e shumicës, e cila njëkohësisht siguron objektivitetin dhe pajtueshmërinë politike. Në kuadër të këtij procesi vlerësoj së **pajtueshmëria politike është vendimtare**. (Timčo Mucunski, Fakulteti Juridik Justiniani i Parë, Shkup, Maqedoni, Konsultime rajonale me studentët dhe shkencëtarët e rinj mbi hartimin e Statutit të KOMRA-së, Zagreb, Kroaci, 17 dhjetor 2010)

Neni 28.

Zgjedhja e anëtarëve dhe anëtareve të Komisionit nga ana e kryetarit/kryesisë të shteteve kontraktuese

1. Kryetari/kryesia e shtetit kontraktues kryejnë zgjedhjen përfundimtarëve të anëtarëve dhe anëtareve të Komisionit, të cilët zgjedhën në shtetin kontraktues në mesin e kandidatëve dhe kandidateve nga lista të cilën ia dërgon Këshilli seleksionues.
2. Kryetarët/kryesitë e shteteve kontraktuese do e informojnë njëri tjetrin mbi zgjedhjet e tyre 30 ditë nga dita kur Këshilli seleksionues iu dërgojnë listën e kandidatëve, para se për këtë ta informojnë publikun.
3. Kryetarët/kryesia e shteteve kontraktuese shpallin emrat e anëtarëve dhe anëtareve të Komisionit 15 ditë nga dita kur të gjithë pranojnë njoftimin nga paragrafi 2 të këtij neni.

(...) me rastin e zgjedhjes së anëtarëve të komisionit, mendoj se domosdo **duhet të zgjidhen në parlamente**, e jo nga kryetari, sepse parlamenti është organ ligjvënës, dhe ai është zgjedhur drejtpërdrejt nga vota e popullit, dhe për këtë arsye mendoj se zgjedhja në parlament është më e mirë. (Edin Smailović, Fakulteti Filozofik, Universiteti në Lubjanë, studimet post diplomike,

Bijelo Polje, Mali i Zi, Konsultime rajonale me studentët dhe shkencëtarët e rinj mbi hartimin e Statutit të KOMRA-së, Zagreb, Kroaci, 17 dhjetor 2010)

Neni 30.

Zgjedhja e kryesuesit/kryesueses dhe miratimi i Rregullores

1. Anëtarët dhe anëtares e Komisionit zgjedhin anëtarin kryesues / anëtares kryesuese dhe miratojnë Rregulloren e punës së Komisionit në afat prej 60 ditësh nga dita e mbledhjes konstitutive.
2. Anëtarët dhe anëtares e Komisionit mund të vendosin që funksioni i Kryesuesit/kryesues të kufizohet në periudhë të caktuar kohore.

*(...) neni 30., është “anëtarët dhe anëtares e komisionit mund të vendosin që funksioni i kryesuesit të kufizohet në periudhë të caktuar kohore”. Mendoj se nuk duhet të jetë e shkruar “mund të vendosin” por që atë duhet menjëherë ta vendosin, sepse ai është personi i cili çdoherë do të paraqitet në emër të komisionit dhe ndoshta **do të duhet kufizuar periudhën kohore të atij mandati.*** (Danilo Ajković, Fakulteti Juridik, Podgoricë, Mali i Zi, Konsultime rajonale me studentët dhe shkencëtarët e rinj mbi hartimin e Statutit të KOMRA-së, Zagreb, Kroaci, 17 dhjetor 2010)

Neni 31

Kuorumi për vendimmarrje

1. Kuorumi për punën e Komisionit ekziston kur janë të pranishëm së paku 14 anëtarë dhe anëtares të Komisionit.
2. Komisioni tenton që të gjitha vendimet të merren unanimisht, e kur është e pa mundur të arrihet konsensusi, së paku 14 anëtarë/anëtares duhet të pajtohen me marrjen e vendimit.
3. Komisioni mund të konstatojë se për miratimin e vendimit procedural është i mjaftueshëm pëlqimi i shumicës së thjeshtë të të gjithë anëtarëve dhe anëtareve.

*(...) e keni paraparë që kuorumi për punën e komisionit të jetë 14 anëtarë. Kjo do të thotë se ai do të mund të funksionojë edhe pa prezencën e njërit shtet, përfaqësuesve të njërit shtet (...) propozoj që të ekzistojë një shumicë e kualifikuar, nëse doni mund ta leni këtë dy të tretat (...) me shtesë që të jetë **prezent së paku nga një anëtarë nga [secili] shtet.*** (Boban Misoski, Fakulteti Juridik, Universiteti Kiril i Metod, Shkup, Maqedoni, Konsultime rajonale me studentët dhe shkencëtarët e rinj mbi hartimin e Statutit të KOMRA-së, Zagreb, Kroaci, 17 dhjetor 2010)

Neni 39.

Zyret e Komisionit në shtetet kontraktuese

1. Komisioni themelon zyret në shtetet kontraktuese dhe, me propozim të Sekretarit ekzekutiv, emëron dhe shkarkon personat në krye të tyre.
2. Zyret në shtetet kontraktuese gëzojnë të drejtën që, në konsultim me Sekretarin ekzekutiv, të themelojnë ekipet për hetuesi mobile dhe zyret territoriale vendore në vendet tjera në territorin e shtetit kontraktues, si dhe të emëroj dhe shkarkoj shefat e ekipeve, gjegjësisht të zyreve territoriale vendore.
3. Në propozim të Sekretarit ekzekutiv, Komisioni mund të themeloj edhe ekipin hetues mobil, me autorizimin që të grumbulloj të dhëna në cilindo prej shteteve kontraktuese.
4. Të punësuarit dhe bashkëpunëtorët në zyrat e shteteve kontraktuese dhe ekipet, angazhohen pa marr parasysh nënshtetësinë e tyre.

(...) mendoj se do të ishte më praktike që në të gjitha (... [zyrat] (...)) të jenë të përfshirë njerëzit nga shtetet e ndryshme. (Edin Smailović, Fakulteti filozofik, Universiteti në Lubjanë, studimet post diplomike, Bijelo Polje, Mali i Zi, Konsultime rajonale me studentët dhe shkencëtarët e rinj mbi hartimin e Statutit të KOMRA-së, Zagreb, Kroaci, 17 dhjetor 2010)

Neni 44.

Përmbajtja e Raportit përfundimtarë

1. Raporti përfundimtarë përfshinë hyrjen, faktet relevante mbi krimet e luftë she shkeljen e rënda e të drejtave të njeriut, listën e humbjeve në njerëz, listën e personave të humbur, listën e vendeve për robërim, dhe rekomandimet.
2. Në mes tjerash, rekomandimet kanë të bëjnë me:
 - (a) hapat e mëtejme të shteteve nënshkruese drejtë përparimit të mirëbesimit në mes të shteteve dhe bashkësive në hapësirat e ish Jugosllavisë;
 - (b) modelin përkatës të reparacioneve materiale dhe simbolike, mënyrën për reformimin e institucioneve si dhe mekanizmat me të cilët sigurohet integriteti i fakteve të vërtetuara në sistemet e arsimit (edukimit) të shteteve kontraktuese;
 - (c) mënyrën e monitorimit të zbatimit të rekomandimeve të Komisionit, që mund të përfshijë edhe propozimin për themelimin e mekanizmit të veçantë për realizimin e qëllimit të tillë;

[komisioni] mund të japë rekomandime, siç është tashmë një iniciativë për të shkruar një libër të përbashkët historie në nivel të tërë Ballkanit, që faktet të cilat do të vërtetohen gjatë kohës së punës së komisionit, do të duhej të futen në atë libër të historisë. Interpretimi është diçka tjetër, por vërtetimi i fakteve apo faktografia do të duhej të jetë i njëjtë për të gjithë. (Renata Eremić, Fakulteti i shkencave politike në Universitetin e Beogradit, studimet post diplomike për Paqe,

Zrenjanin, Serbi, Konsultime rajonale me studentët dhe shkencëtarët e rinj mbi hartimin e Statutit të KOMRA-së, Zagreb, Kroaci, 17 dhjetor 2010)

Neni 45.

Gjetjet mbi kryerësit

1. Komisioni ka autorizim që në Raportin përfundimtarë të vërtetojë se faktet e grumbulluara tregojnë për atë që personi i caktuar ka kryer krim lufte, gjegjësisht shkelje të rëndë e të drejtave të njeriut. Gjetja e tillë nuk ka efekt të aktgjykimit gjyqësor, dhe nuk paragjykon vendimin e gjykatës në rast të një ndjekje penale.
2. Në raportin përfundimtar, Komisioni nuk mund të nxjerr gjetjet kundër ndonjë personi nëse nuk ka ndërmarr të gjithë hapat e arsyeshëm, që:
 - (a) të njoftoj atë person lidhur me qëllimin e vet që të nxjerr gjetje jo të volitshme;
 - (b) ti komunikojë personit përmbajtjen e gjetjes, të dhënat në bazë të të cilave nxirret gjetja, si dhe shkaqet në të cilat është bazuar gjetja e tillë, dhe
 - (c) ti ofrojë personit mundësinë që në afat të arsyeshëm të përgjigjet në gjetjen e propozuar.

(...) nëse ndonjë person i caktuar nuk ka mundësi të përgjigjet në këto të gjetura, si do të bëhej atëherë kjo, sepse çfarë të bëhet nëse dikush ka vdekur, siç e përmendët rastin e zotëri Milosheviqit. (Danilo Ajković, Fakulteti Juridik, Podgoricë, Mali i Zi, Konsultime rajonale me studentët dhe shkencëtarët e rinj mbi hartimin e Statutit të KOMRA-së, Zagreb, Kroaci, 17 dhjetor 2010)

Sa i përket nenit 45, aty duhet të kemi shumë kujdes, sepse nuk mund ta rrënojmë njërin prej parimeve themelore që personit nuk mund ti gjykohet dy herë për të njëjtin krim, ndoshta do të mund të caktohet ndonjë normë e sanksionit moral për këta autorë të krimeve. (Jovana Ramović, Fakulteti Juridik, Universiteti në Podgoricë, Podgoricë, Mali i Zi, Konsultime rajonale me studentët dhe shkencëtarët e rinj mbi hartimin e Statutit të KOMRA-së, Zagreb, Kroaci, 17 dhjetor 2010)

3. [ALT. A: Nga pikëpamja e rasteve të cilat janë proceduar në prezencë të akuzuarit, para Gjykatës ndërkombëtare ose vendore, Komisioni do ti referohet aktgjykimit përkatës në raportin përfundimtarë.]

[ALT. B: Nga pikëpamja e rasteve të cilat janë proceduar në prezencë të akuzuarit, para Gjykatës ndërkombëtare ose vendore, Komisioni mund ti referohet aktgjykimit përkatës në raportin përfundimtarë.]

Neni 46.

Obligimet e parlamenteve dhe qeverive për shqyrtimin e Raportit përfundimtarë

1. Pas publikimit të Raportit përfundimtar, kryetari/kryesia e çdo shteti kontraktues, raportin ia dërgon kryetarit të parlamentit. Në afat prej një muaji pas pranimit të raportit, kryetari i

parlamentit thërret seancë të veçantë të parlamentit, me qëllim të shqyrtimit të gjetjeve dhe rekomandimeve nga Raporti. Në seancë marrin pjesë një ose më shumë anëtarë të Komisionit.

2. Në afat prej 6 muajsh pas publikimit të raportit përfundimtarë të Komisionit, qeveria e çdo shteti kontraktues miraton dhe publikon në gazetën zyrtare të shtetit kontraktues qëndrimin mbi zbatimin e rekomandimeve.
3. Në një afat të arsyeshëm pas përgjigjes nga qeveria sipas paragrafit 2 të këtij neni, kryetari i parlamentit në çdo shtet kontraktues thërret seancën speciale të parlamentit me qëllim të shqyrtimit të përgjigjes së qeverisë dhe angazhimit të mundshëm të parlamentit me qëllim të zbatimit të rekomandimit të Komisionit.

*(...) **raporti i komisionit, pasi që e formojnë shtetet, duhet të jetë obligativ për shtetet, do të thotë që të futet klauzola që të gjeturat deri te të cilat ka ardhur komisioni duhet të pranohen në parlament, sepse vetëm në këtë mënyrë do ta keni mbrojtjen ligjore.*** (Edin Smailović, Fakulteti Filozofik, Universiteti i Lubjanës, studimet post diplomike, Bijelo Polje, Mali i Zi, Konsultime rajonale me studentët dhe shkencëtarët e rinj mbi hartimin e Statutit të KOMRA-së, Zagreb, Kroaci, 17 dhjetor 2010)